



---

# **KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN**

**Municipal Assembly of Decan**

## **TRANSKRIPTI**

**Mbledhja e Kuvendit të Komunës**

**(Legjislatura e VII , mbledhja e VIII ) me dt.26.09.2024**

**DEÇAN**

**e Enjte, 26 Shtator 2024**

**Faqe 1 nga 21**

## **Hajdar Sutaj**

Përsëhendetje i nderuari kryetar i komunës së deçanit, zotëri Bashkim Ramosaj, të nderuar drejtorë të drejtorive komunale, të nderuar kolegë e kolege, anëtarë të kuvendit të komunës së deçanit. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 8-të të rregullt të kuvendit të komunës së deçanit. Për mbledhje para se të lexojë rendin e ditës, konstatoj se nga 27 anëtarët e kuvendit, 24 janë prezent që ka kurum të mjaftueshëm për me vazhdu me punimet e kuvendit, ashtu siç e keni marrë edhe materialin për rend të punës propozoj këtë renditje:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për vitet 2025-2027,
3. Raporti gjashtëmujor i kryetarit të komunës, materialin e të cilit e keni nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të komitetit të komuniteteve, po ashtu materialin e keni nga mbledhja e kaluar,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në periudhën deri në 1 vit,
7. Shqyrtimi i draft strategjisë për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027,
8. Njoftimi i drejtorisë për arsim për përgatitjet e vitit shkollor 2024-2025,
9. Të ndryshmet.

Kolegë nëse ndokush prej juve ka diçka me shtu në raport me rendin e ditës urdhëroni. Nuk ka, atëher kush është për këtë rend dite A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi i komunës në mënyrë unanime e ka miratu rendin e punës. Vazhdojmë me pikën e 1-rë l.shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar a ka dikush diçka në lidhje me diskutimin, Orges Tafilaj e ka fjalën.

## **Orges Tafilaj**

Faleminderit kryesues përsëhendetje për të gjithë, fillimisht transkripti nuk ka përfshirë 1 pjesë të madhe të fjalëve tona që i kemi thënë, sidomos te pjesa e diskutimit, lidhje me raportin e auditorit jashtme do të thotë mungon komplet diskutimi ynë. Pjesa tjetër është që ka shkuar te fjalive në raste të shumta po nisem nga pjesa e fjalimeve të mia dhe njëkohësisht besoj që ka nevojë për një lekturim të thellë ndoshta duhet të shohim mundësinë që të kemi 1 lektor të angazhohet qoftë kontratë me vepër ose në mënyrë tjetër sepse, sidomos te pjesa e pikësimit ka gabime të shumta faleminderit.

## **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Orges a ka dikush tjetër. Atëherë ne bashkë me sygjerimet që i dha kolegu Orges Tafilaj e qes në votim transkriptin kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që me 21 vota për dhe 2 vota abstenim pa asnjë kundër e kemi miratu transkriptin e mbledhjes së kaluar të kuvendit të komunës. Jemi te pika 2-të shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për vitin 2025-2027 e para se me hapë diskutimin për këtë pikë ja kaloj fjalën drejtoreshës për buxhet dhe financa Dafina Cacaj drejtoreshë fjala për ju.

## **Dafina Cacaj**

Mirmëngjes për të gjithë përsëhendetje, falemnderit kryesues për fjalën, i nderuar kryetar, të nderuar asambleistë, buxheti i komunës së deçanit për vitin 2025 sipas qarkores së 2-të që ka ardhur do të jetë 14.401.935 euro. Secilat janë të ndara sipas kategorive 7.606.274 shkojnë për paga dhe meditje e cila është pjesa më e madhe e buxhetit 2.650.000 janë të ndara për mallra shërbime 250.000 janë për shpenzime komunale, subvencionet transferet 350.000 edhe investime kapitale janë 3.545.661. Ndërsa për 2 vitet e tjera janë vetëm parashikime, pasi të cilat mundën me ndryshue e kamë thënë edhe më herët në bazë të regjistrimit të popullsisë që u bë këtë vit. Viti 2026 dhe 2027 mundet me pas ndryshime vetëm nëse ndërrohet formula e kalkulimit, atëherë ndoshta mundemi me mbetë në këtë që jemi, por nëse vazhdojmë me regjistrimin e fundit, atëherë komuna e deçanit dëmtohet më shumë se 1 milion. Po parashikimet që mundën me qenë për vitin 2026 janë 15.096.315 buxheti total për paga janë 8.024.619 mallra shërbime 2.703.000 shpenzime komunale 261.250 euro subvencione transfere 367.500 euro investime kapitale 3.739.946 euro, ndërsa për 2027 buxheti do të jetë e 15.806.774 euro, paga meditje 8.449.924 euro mallra dhe shërbime 2.757.000 shpenzime komunale 274.313 subvencione 396.900 investime kapitale 3.928.577. Ndarja sipas buxhetit të planifikuar,

është sipas tabelave të cilat i keni të bashkangjitura me propozimin për buxhet na i kemi ndarë investimet kapitale në projekte të cilat janë shumica në vazhdim dhe përfundojnë në vitin tjetër shumë pak ka projekte të reja të cilat kemi mujt me i planifiku, investimet, mallra shërbime nuk ndahen me emra të veçantë qka mundemi me investu ose qka mundemi me bë në vitin tjetër, mirëpo përfshihen tenderët e vogla që kanë investime më të vogla se 1 mijë euro për njësi kur është produkti ose mirmbajtje të cilat hynë aty dhe shërbime tjera edhe furnizimet e vogla Unë nuk kam diçka me shtu, pasi që ju i keni krejt në tabela dhe projektet edhe kategorit tjera.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit drejtoreshë, fillimisht e kalojmë fjalën te përfaqësuesit e subjekteve politike nga AAK-ja Arjan Dobraj.

#### **Arjan Dobraj**

Faleminderit kryesus i nderuar kryetar i komunës së Deçanit zotëri Bashkim Ramosaj, të nderuar anëtarë të drejtorive, të nderuar kolegë dhe kolege asambleistë Drejtoresh Dafina Cacaj të falënderoj për sqarimet që i bëre në lidhje me projekt buxhetin për vitet 2025-2027 në fakt ne si asambleistë ose përfaqësues të zonave prej nga vijmë, po të gjithë që jemi këtu, ne jemi dëshmitarë të shumë punëve në fakt të kryera, që realisht i ka prek gjitha lokacionet e komunës së deçanit dhe në fakt edhe për këtë është i shprehur niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me të cilët bisedojmë çdo ditë. Në fakt ka edhe shumë kërkesa të qytetarëve, siq e thashë nga zonat për të cilat vijnë, por e kemi parë që shumica e këtyre projekteve kanë qenë të përfshira në vitin që tani po lëmë pas, por edhe në projektbuxhetin për vitin që do vijë, projektet e kryera edhe ato që janë vazhdimësi, e që normal që do ta lehtësojnë shumë jetën e qytetarëve tanë në tërësi në gjitha fshatrat dhe vendbanimet, prandaj ne si grup e përkrahim me shpresën se këto projekte të realizohen në mënyrë dhe në kohë të caktuar falemnderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Arjan, nga Ldk-ja kush? Hyrije Dobrunaj.

#### **Hyri Dobrunaj**

Sa i përket projektbuxhetit për për vitet pasuese, ldk-ja nuk e mbështet këtë projektbuxhet, sepse nuk është buxhet i zhvillimit për komunën e deçanit, këto projekte të cilat i kemi të pasqyruara këtu janë në vazhdimësi që disa vite, mirëpo kjo është e kuptueshme që nuk mund të realizohen dhe nuk do të realizohen dhe nuk i përfshin, nuk është gjithëpërfshirës, meqenëse na e dimë se gjashtëmujorin e 1-rë komuna e deçanit ka pagu 4 milion ndëshkime gjyqësore do të thotë edhe këto deri në fund vitit Munden me shku edhe katra tjera më shumë sesa i kemi investimet kapitale që veq kemi të shpenzume që i ka marrë përmbaruesi kjo nënkupton që ky buxhet është veç sa për sy e faqe dhe nuk e mbështesim vërejtjet e mia pyetjet e mia e kamë bërë edhe në KPF po e shoh që nuk janë pasqyru këtu në procesverbal, mirëpo ndoshta kolegët e kanë edhe ndonjë pyetje shtesë po sa na përket neve Ldk nuk e mbështesim sepse nuk është buxhet për zhvillimin e deçanit.

#### **Hajdar Sutaj**

Nga Vetëvendosja Faton Selmanaj.

#### **Faton Selmanaj**

Përsëritet për të gjithë komentet tona dhe ne e kemi jap edhe në komision për politik e financa. Njëjtë si vitet e kaluara edhe këtë vit ky propozimprojekt buxhetor është i orientum kryesisht nga bjeshkët e në veçanti ka bjeshkët të cilat janë bjeshkë që i frekuenton edhe vetë kryetari Ka projekte të mira nuk mundem me thanë që s'ka projekte të mira për të cilat ia kish vlej të votohet ky buxhet, por në raport me vlerën e përgjithshme të buxhetit janë fare pak ato projekte gjë që edhe ne nuk jemi për këtë projekt, për shembull po i përmendi disa ujësjellësi në bjeshkë të madhe kem shumë fshatra që ska ujë të pijes kryetar nuk kan ujë të pijës dhe nuk mendoj që është në rregull me çu fillimisht në bjeshkë ndoshta ka kaluar pak në mani prej meje që jam duke e përsërit në vazhdimësi këtë problematike e ujit të pijes dhe kanalizimeve kështu por me të vërtetë nuk është në rregull Renovimi i rrugëve dhe rrugicave ne Deçanit e ri. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për në fshatin Vëlle sa herë duhet mu investu atje? Pastaj blerja e veturave zyrtare 60.000 euro Ndërtimi dhe asfaltimi prap i rrugës për në bjeshkën e madhe vazhdim bjeshken tande Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për në bjeshken e madhe prapë faza e 2-të, ndërtimi i objektit të mbeturinave të vëllimshme projekti i ri ndërtimi i deponisë së mbeturinave inerte janë të 2 projekte të reja gjë që nuk ke dhënë lokacione për to, realisht e kemi ndarë një por ministria nuk patë leju në fshatin vulaj që edhe në atë kohë kemi qenë kunder përkrahjes sepse ka qenë

lokacion jo në rregull dhe jo adekuat për atë punë kaq kamë fillimisht.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit zotëri Mon Selmanaj.

### **Mon Selmanaj**

Faleminderit kryesues përshëndetje kryetar përshëndetje ju gjithë të pranishëm. Komuna Po vazhdon me projektin buxhet të mbijetesës nga 14.401.000 euro vetëm 3,5 milionë euro janë ndarë për projekte kapitale Kur në këto mjete kishin përfutur qytetarët Dhe do të ishin aktivizuar bizneset vetëm 350.000 janë ndarë për subvencione dhe transfere pra ky projektbuxhet në vitin 2025 nuk është i përgatitur mirë, nuk na ofron kurrfarë shifra, as krahasuese në raport me vitin 2024 nuk ka të detalizuara shpenzimet për secilin kod buxhetor. Ne jemi anëtarët e kuvendit që duhet me votu këtë buxhet dhe duhet ti kemi të dhënat më sintetike dhe më analitike për secilin program buxhetor sepse nuk mund ta botojmë shifra buxheti përmendsh pa të dhëna të detalizuara. Nëse i shikojmë më kujdes këto shifra të cilat janë ofruar shohim se ky projektbuxhet i komunës është krejtësisht shpenzues dhe aspak buxhet i paraparë për zhvillimin e komunës në anën tjetër, është për keqardhje që mjetet që po planifikohen nuk po shpenzohen ashtu siç kërkon ligji dhe rregullat e shpenzimit të mjeteve këtë e ka dëshmuar edhe zyra e auditorit të përgjithshëm përmes raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare që për vite me radhë ka qenë opinion i kualifikuar dhe me ngritje të shumë çështjeve që karakterizohen me shkelje të procedurave ligjore dhe në vazhdimësi kanë ngritur shqetësimet për keqmenaxhimin e mjeteve. 702 euro është paga mesatare mujore e 21 të punësuarve në zyrën e kryetarit, numri i madh i këtyre të punësuarve në këtë zyrë mendoj se shkakton dëm të buxhetit dhe nuk arsyetohet puna e tyre, këtë e dëshmon edhe shuma e mjeteve prej 467.660 euro që janë planifikuar për mallra dhe shërbime për kokë të punëtorit i bie që shpenzohet 1 muaji 1.855 euro ose 22.267 euro ne muaj. Ju lutem zoti kryetar na shpjegoni apo si i arsyetoni të gjitha këto shpenzime enorme për mallra e shërbime të planifikuara në zyrën tuaj. Të nderuar kolegë në tabelën e ofruar për emërtim të projekteve për investime kapitale vërehet 1 orientim i gabuar i njëanshëm jo mirë i studiuar, projektet të cilat me vite të tëra po investohet në to dhe nuk kanë përfundim e ato janë fshati turistik Podi Gështenjave, Laku i kryqes, Shtëpia grinë bjeshkatore, Bjeshka e madhe, Belleja etj. Disa prej këtyre projekteve i gjeni nga 2- 3 herë në planifikimin për vitin 2025 Projekte këto të cilat

### **Hajdar Sutaj**

Mundësisht ja vazhdoni.

### **Mon Selmanaj**

A shkuan 7 minuta zotëri kryesis, tendenca e ekzekutivit për ti arsyetuar këto investime me zhvillimin e turizmit malor, duke anashkaluar gjithë sektorët e tjerë që çuan drejt 1 zhvillimi më të qëndrueshëm dhe më të shpejtë ekonomik. Unë do të propozoj disa pika me arsyetime, të cilat mendoj që duhet të përfshihen në këtë projekt buxhet. Investimet në infrastrukturë, mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore për të rritur sigurinë në trafik këtu hyjnë rrugët lokale, të mirëmbahen (verës), të kenë (shpenzime) vertikal dhe horizontal. Jemi dëshmitarë që gjitha rrugët dytësore janë të ngushtuara dhe askush nuk i ka mirëmbajtur me vite të tëra. Prioritet tjetër duhet të jetë ndërtimi i kanalizimeve, trajtimi i ujërave të zeza për të mbrojtur burimet ujore dhe mjedisin, rasti më i keq që është ai në Dranoc edhe sot e kësaj dite, ata që frekuentojn atë rrugë atje nuk mundem me kalu prej ernave të këqija Ndërhyrja me urgjencë në sanimin e shtretërve të lumenjve, posaçërisht të atij të Lloqanit i cili vitet e kaluara ka bërë dëme të mëdha në fshatrat e Rastavic dhe Baballoq. Për cialt dëme janë bërë dhe vlerësimet nga komisioni profesional. Uji i pijes mungesa e madhe e tij gjatë stinës së verës, pothuajse në gjysmën e fshatrave të komunës duhet të jetë një sinjal alarmi për ju zotëri kryetar. Fatkeqësisht ne bashkatdhetarët tonë që po na vijnë faleminderit prej tyre po hasin në vështirësi me mungesën e ujit dhe kjo po jep një pasqyrë të keqe shumë te ata dhe te na si familjarët e tyre. Përmirësimi i infrastrukturës urbane, riparimi i trotuareve të dëmtuara, orëmatësit e dëmtuar në trotuar dhe rregullimi vendkalimeve për persona me aftësi të kufizuar, mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit dhe kanaleve për urja sipërfaqësor në mënyrë që të ndalohen përmytjet që i kishim vitet e kaluara. 3 prioritet në bujqësi, prioriteti numër një në bujqësi duhet të jetë rritja e buxhetit nga 250.000 e paraparë për shpenzime kapitale në vitin 2025 e që në krahasim me vitin 2024 është 1 ngritje e lehtë, prej 50.000 eurove për mua është e pamjaftueshme dhe jo vizionare për 1 bujqësi të zhvilluar në të gjithë sektorët e saj. Një bujqësi e zhvilluar do të jetë një mbështetje e madhe nesër të një zhvillimi të hovshëm turistik që ne si komune pretendojmë. Mbështetja për bujqësinë nga ne sod do të thotë 1 zhvillim ekonomik, zhvillimi i turizmit apo prosperiteti i qytetarëve nesër, prandaj kushtojini vëmendje më shumë bujqësis sot që të kemi më shumë nesër pemë dhe

perime produkte të qumështit, produktet e mishit, mjaltit etj. Të nderuar kolegë në diskutimin tim rreth këtij projekt buxheti u përpoqa të jem i qartë dhe i argumentueshëm për projektet në fjalë njëkohësisht jamë përpjekur të shfaq mendimet apo idete e mia për fusha dhe projekte të caktuara ju faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit zotëri Mon, Yllarta Thaqi e ka kërku fjalën, meqenëse ka një lëvizje të ulëses, nuk e di kush ka qenë ulë aty përpara që me lëshu mikrofonin në rregull qe Yllarta prapë faleminderit.

#### **Yllarta Thaqi**

Faleminderit shumë përshëndetje për të gjithë faleminderit per fjalën jemi tek pika më e ndjeshme dhe flasim për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit për vitin 2025-2027. Flas në cilësinë e qytetarës të kësaj komune jemi te vetëdijshëm se me 14.401.935 euro nuk mund të përfshihen të gjitha por pak më shumë është dashtë jepet prioritet bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe rinisë. Kur flasim për bujqësi, nuk kisha dashtë me qenë 250.000 euro por 500.000 euro, kur i krijon ujë kanal, infrastrukturë rritet edhe vullneti për punë, subvencione, mjetet për punë, sera të tjera, duke subvencionuar bujqësinë në rritjen dhe zhvillimin e komunën tonë, e pa e lanë anash edhe turizmin. Nese i krijon infrastrukturë bujku, patjetër se ka me u rritë edhe punësimi ndërsa sa i përket turizmit, nuk jemi kundër shkuarjes në bjeshkë, por bjeshka tashmë është bërë lluks dhe nuk jemi në kohën e baballarëve tanë që kanë qëndru me 3 muaj, për shembull në bjeshkë dhe i kanë largu bagëtinë nga ketu, por me kriju ma shumë mundësi për zhvillim, por tashmë shkojnë ata që kanë pare edhe që i kanë senet pak më mirë. E kalojme tek pika e buxhetit kërkoj që të rritet prej 250.000 në 500.000, ndërsa edhe tek shëndetësia është dashtë që të ketë projekte pak më tepër është viti i 3-të që kërkoj një mamografi nuk e di pse anashkalohe merrni model komunat e përiferata që kanë numër të njëjtë të banorëve me komunën tonë, ndërsa e kanë të siguruar mamografin. Më shumë mjete duhet të ndahen për personat me nevojë nuk them që nuk mbështeten personat me nevojë, sepse në komunën tonë kemi mjaft persona me nevoja, të cilëve ju ndahen mjete ose 2 herë në vit ose edhe më tepër, por duhet të kenë prioritet edhe më shumë. E këto janë kërkesat e mia, jamë pro këti buxheti, por kërkoj që këto kërkesa të mirrën parasysh faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Yllarta, Vatoni Istrefaj e ka fjalën.

#### **Vatoni Istrefaj**

Faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket kësaj pike pra nese është një nga pikat më të rëndësishme gjatë kësaj asambleje për ne është projekt buxheti por në këtë projektbuxhet kryetar e shohim qartë se më shumë është projektuar për ti paguar borxhet e mëparshme sesa për projektet e reja e këtë e tha edhe vetë drejtoresha për buxhet dhe financa që tha shumica e projekteve janë vetëm ato që kanë qenë në vazhdimësi dua të pyesë kryetar ku e ke paraparë rinin në këtë projekt buxhet, përkrahje ndaj tyre edhe investimet në shëndetësi kryetar nuk kam parë asgjë tjetër vetëm se 1 kulm të 1 qkmf-je që e keni bërë renovim. Po ashtu kryetar e shoh ujësjellësin në bjeshkë të madhe dhe vazhdimin me bjeshkë tjera i keni ndarë 30.000 euro, gjë që shumë e mirë por ku .. çfarë po ndodh me fshatra të cilat nuk kanë ujë të pijes e as shtrirje mirë të rrjeteve nuk kanë, Nëse mundesh me i gjujtë kompetencat te hidrodrini mundesh me thonë edhe atë, po pse kryetarët gjatë këtyre 4 muajve, për shembull në fshatin Strells nuk ke dalë asnjëherë edhe me i pa qytetarët se çfarë po hjekin për ujë të pijes mundesh me shku te kroni Curra dhe me i pa hidroforat vetëm sa nuk e ka mbytur rryma ndokënd. Përpos kësaj kryetar e shoh elektrifikimin e bjeshkës së Strellcit këtë projekt e keni paraparë edhe për vitin 2023, në vitin 2024 e keni larguar pastaj ndoshta pas bisedimeve me bashkfshatar aty e paskeni vendosur apert në projektë kështu që për vitin 2025 në këtë projekt nuk është paraparë asnjë euro deri në vitin 2026 a kishe mundur me ma spjegu edhe këtë pjesë pakë faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, kryetar a deshiron me i dëgju te gjith diskutust a deshiron me u përgjig,j bë rregull Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën.

#### **Miftar Ahmetxhekaj**

Faleminderit shumë kryesues përshëndetje për të gjith, realisht nuk do të kisha dashur ta fillojë kështu diskutimin tim për të sqaruar se çka është buxheti këtë do duhej ta dinte kryetari, buxheti përpos që është 1 prej dokumenteve më të rëndësishme, i ka edhe 2 elemente, po dy rrafshe kuptimin juridik, ju dini kryetari ka

cilësinë e ligjit për shkak se miratohet ose aprovohet nga organet më të larta, ndërsa në kuptimin ekonomik është njëfarë mekanizmi është 1 instrument financiar, i cili prapë i ka dy rrafshë, i ka të hyrat dhe shpenzimet, të cilat të dyja duhet të jenë të sakta dhe të qarta ose precize. Për vlerësimin tim ju si ZKA nuk e keni bërë as të parën e as të dytën dhe këtë e bazoj pikërisht në dokumentet të cilën ju na keni ofruar. Nëse i referohemi fushatës të cilin ju keni bërë para 3 vitë ose 4, prej premtimeve bazike ka qenë infrastruktura dhe investimet kapitale, referuar tabelës financiare nga 14 milion e 400 e sa vetëm mallra dhe shërbimi i ke 7.6 nëse e përkthejmë në përqindje i bie 52 përqind, nëse e krahasojmë me vitin paraprak nga 7,2 i bie 311.000 e ki rritjen e shpenzimit. Vetëm në zyrën e kryetarit ka rritje enorme nga 18 të punësuar këtë vit i keni 21. Nëse shkojmë te shpenzimet e tjera, unë i kom llogaritë me përqindje mallra shërbime 18 subvencionin më falë subvencione 2.4 është një rritje e lehtë, shpenzime komunale 1.8 dhe jemi të shpenzimet kapitale është 3.5 dhe kjo është projekte të përsëritura, projekte në vazhdimi dhe a e di pse bëhet kjo, për shkak se nuk ka projekte bazike dhe këtë pasë disa seancave ju beni realikim të mjeteve se ju nuk jeni te sigurt kjo është ajo shkelja juridike me qenë se unë kryetari, jam përfaqësues i fshatit dhe vi me votat e qytetarve, e kamë për detyrim edhe moral që ti adresoj projektet dhe kërkesat e tyre të cilat janë jetike dhe për cilat ju i keni premtuar, një prej tyre është kanalizimi, asnjë meterë e paraparë për projektin e ardhshëm për 3 vite kanalizim Rrugët e fshatit Isniq të cilat duhet ti cekim emër për emër, rruga Cen Imeri familjes Imeraj, rruga Sali Azmonve të pa asfaltuara keto jan emertime zyrtare të cilat e kanë nje kuot të gjatësis mbi 150 metra Rruga Isuf Haklaj e cila lidhet me rrugën Avdyl Osdautaj. Rruga e familjes Dem Ali Haklaj është tmerrësisht me pa në çfarë gjendje është pra kjo lidhet me rrugën Avdyl Osdautaj. Ura dhe rruga e Met Osmanaj te familja Osmanaj, rruga Maxhun Tishukaj, rruga Gani Balaj pjesa e 2-të e familjes Balaj, kanalet e ujitjes ndryshim publik i lenë përgjyst pa dasht me egzagjeru për vlerësimin tim nuk është projekt ose nuk është buxhet premtus kryetar për vlerësimin tim do duhej të ishin ne fokusin tuaj kryetar, për mendimin tim ky buxhet edhe pse spo thom shpenzimet e këqija nuk do të duhej ta kishte aprovimin e asambles komunale në ditën e sotme faleminderit shumë.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë Blinera Lokaj, nderum në lidhje me transmetimin..jo vazhdo e nderume.

#### **Blinera Lokaj**

Faleminderit kryesus përshëndetje për të gjithë, në këtë projekt propozim shohim se ndarja e investimeve kapitale është bërë në mënyrë jo të drejtë dhe jo proporcionale, pasi që vlera më e madhe e investimeve kapitale është planifikuar për bjeshkë dhe për turizëm. Meqenëse unë vij nga regjioni i Vokshit çdo ditë përballemi me mungesën esenciale të ujit të pijes, kemi mungesë të trotuarëve, problemet e shumta me ndriçimin publik, për shkak se shumë shtylla nuk janë funksionale, probleme me kanalizimin me rrugicat e paasfaltuara e shumë e shumë problematika të tjera. Kryetar po kthehem sërish te turizmi meqenëse jeni dashamirës i bjeshkës, me siguri jeni njoftuar për renovimin e 5 urave që çojn në bjeshkën Pllaçicë e Vokshit të cilat janë renovuar me punën vullnetare dhe me vetkontributin e bashkëfshatarëve të regjionit të Vokshit, Junikut dhe Dobroshit, të cilat i kanë rinovuar këto ura me dërrasa. Përkundër premtimeve tuaja të shumta që do ti rinovoni me beton, po e shoh se ky projekt nuk është përfshirë në projekt buxhetin e vitit 2025, madje as në projeksionet për 2 vitet e ardhshme, andaj me kërkesën e frekuentuesve të asaj bjeshke, shpresojmë që do ti rinovoni me beton në mënyrë që të ruhet struktura dhe siguria e tyre. Po ashtu e kam edhe 1 kërkesë nga bjeshkatarët e Vokshit për vitin e ardhshëm të ndani 1 fond të veçantë në mbështetje të çetave tradicionale, meqenëse është si 1 festë apo 1 rast për ti mbledhur bjeshkatarët, po ashtu është 1 ngjarje me rëndësi të madhe kulturore dhe tradicionale.

#### **Hajdar Sutaj**

Mirë është Dug vazhdo.

#### **Erdogan Dautaj**

Përshëndetje për të gjithë sa i përket projektbuxhetit une i kam disa vërejtje në lotin 3 dhe 4 nuk pashë aty që fshatrat edhe Kodralia që janë të gjitha fshatrat ka nevojë për asfaltimin e rrugicave, por këto dyja janë pak ma keq, sidomos pata një pyetje per kryetarin, kjo rruga e batalionit ka pas filluar dhe ende nuk po vazhdon edhe ujërat e zeza sa e pashë nuk është planifikuar që këto 3 vite të bëhet diçka në lidhje këtë sidomos edhe un e kam 1 vërejtje te fshati Dranoc dhe aty është disa vite kjo problematikë e pazgjidhur edhe te uji i pijes kisha lut te kryetari që të bëj presion që të bëhet mbledhja e burimeve për këto fshatra që nuk kanë ujë faleminderit

#### **Hajdar Sutaj**

### **Albesa Cacaj**

Përsëritje për të gjithë atëherë nuk do të zgjatet në fjalimin tim, sepse të gjitha ato që i mendova ti themi i thanë kolegët e mi nga Ldk-ja, por ajo çka pajtohem plotësisht me drejtoreshën e financave është se po drejtoreshë është fakt duke u bazuar në gjitha projektet propozimet kapitale të viteve paraprake, e gjithë projektpropozimi i këtyre investimeve kapitale të parapara për 2025 janë projekte të përsëritur vit pas viti nga viti 2021. Por çështja që kam ngrit vazhdimisht dhe asnjëherë nuk kam marrë përgjigje ka qenë pse stacioni i autobusave komuna e Deçanit që 25 vite pas lufte nuk ka stacion të autobusave, planifikohen ndahen mjete për vitin e ardhshëm, po asnjëherë nuk realizohet ajo çka më ra në sy është se projektet janë të përsëritura si dhe te investimet kapitale nuk kish asnjë projekt sa i përket fushave sportive, duke ditur se në Deçan dhe në rrethinë ka mangësi dhe këto e thotë edhe raporti i performancës komunale vit mbas viti dhe javë zbrit piket, pastaj hapësirat e gjelbrume këndet e lojërave, një nanë me fëmij nuk ka ku me dal edhe me i qit fëmijët me lujt stacioni i autobusave parqe qe do me thon a nuk i ka parapa kryetari këto që jeta botë fillimisht n'rrafsh edhe me mar parasysh kërkesat primare edhe mi marr parasysh edhe mungesën e mospjesëmarrjes qytetarëve kur bëhen dëgjimet publike, sepse ata janë lodh tu ardh tu i adresuar çështjet dhe asnjëherë tu mos u fut në projekte ose në propozim projekte për vitin e ardhshem, faleminderit shumë.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Albesa dikush tjetër.

Atëherë me qenë se nuk ka të lajmruar për diskutim koleg më lejoni vetëm me parashtrur një pyetje ndaj drejtoreshës. Një letër e kemi dërgu dje si komision për emërtimin e rrugëve ka pasë të bëjë me planifikimin e buxhetit për vendosjen e tabelave për emërtimin e reja të rrugëve për vendosjen e tabelave në hyrje të vendbanimeve, për vendosjen e tabelave ku janë të dëmtuara edhe për vendosjen e numrave në shtëpi. Realisht biseduam edhe me drejtoreshën për buxhetin e financa edhe me drejtorin Izet Zenuni që kjo hyn kuadër të mallra shërbime po megjithatë kërkoi që kjo të mbetet edhe në procesverbal që shuma e cila është kërkuar të planifikohet te mallra shërbime, besoj se përgjigjen ma adekuate ka me jep drejtoresha per buxhet dhe financa.

Kryetar a doni ju me u përgjigj apo drejtoresha në lidhje me diskutimet që i patën anëtarët e kuvendit, kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

### **Bashkim Ramosaj**

Se di nuk po e shoh të arsyeshme me e diskutu çdo pikë, sepse ishin shumë, ishin gati si të njëjta në përmbajtje dhe në esens, po du me spjegju shkurtimesht diçka dhe po ashtu me ju lutë që me kanë pjesë hartimit të këtij buxheti për shumë arsye, ajo pse ne kemi projekte në vazhdim nga viti në vit është fuqia buxhetore që komuna e Deçanit e ka për shkak se çdo njeri normal kur e angazhon një projekt, kur don me realizu atë projekt në rast se i ka paratë, dinamikën kohore e cakton sa ma shkurt sepse ka aftësinë për të paguar. Në Deçan ka qenë një ose edhe në komunat qe janë përfaqësuar sikurse Deçani me buxhet duhet kështu me funksionu, mirëpo cili ka qenë standardi çë është arritë? Në 1 qytet, të cilin ndoshta e kemi projektin këtë që na ndodhi tash ne kohen e fundit qa kemi bërë cilen lëvizje e kemi bërë strategjikë e kemi kriju një qytet i cili prej 41.000 banorëve ka mbet në 28.000 banorë, për shkak se politikat shtetërore prej mas lufte deri sot nuk është që kanë bërë ndonjë balancë të harmonizum, sidomos në aspektin e zhvillimit rajonal dhe tash cila është strategjia, cila është ideja? Përtej infrastrukturës lokale, e cila nuk ka me u ndal dhe ka me vazhdu kohë pas kohe duke u kry vendbanim pas vendbanimi dhe ky është obligim i joni është premtimi joni. Unë e di që kom premtu edi qfar kamë marrë përsipër edi qfar skam marrë përsipër, është një zgjidhje kur flasim për sektor të rëndësishëm duhet me qenë shumë të kujdesshëm sepse është 1 sektor i rëndësishëm dhe të tjerë janë zinxhir të rëndësishum pas tij dhe cila është ideja? Ideja është çfarë ka Deçani cili është pozicioni i Deçanit? cilat janë resurset e Deçanit? a po fokusohemi këndeje dhe a po krijojmë një qytet ku përpos banorëve të deçanit ka edhe dikush tjetër qytetar i kësaj republike me ardh mu bë banor i qytetit, për shkak të një standardi për shkak të 1 koncepti tjetër që krijohet unë jam i kësaj mendësie e kamë një ekip në ekzekutiv të cilëve përditë e diskutojmë këtë farë mendësie dhe këtë angazhim dhe po ashtu me shumicën e asamblastave që i takoj dhe me diskutu me ta e flasim brenda kësaj mendësie. Këtu temat që kanë të bëjmë me ata të qënurit popullor hajt se thash diçka unë me bo me ja fillu tash do vretje perball vetvetes ja japi vetes nja 100 vretje per punë qe isht dasht me u kry ose që sjanë ne rregull ose nese jan ne rregull. Në rast se bëhemi racional, në rast se bëhemi të vërtetë atëherë i bie që mundësia për me kriju këtë është brenda mundësis buxhetore brenda kapaciteteve qe i ke. Ju propozoj dhe po ju rekomandojmë edhe po ju lusë Bëhuni pjes e miratimit të buxhetit, sepse është buxhet i cili ndikon në vizionin e të qenurit një qytet atraktiv jo vetëm për ne por edhe për të tjerë faleminderit shumë.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetar e ka kërku fjalën drejtori Rifat Stojkaj urdhëroni drejtor.

## Rifat Stojkaj

Kryesues faleminderit realisht e kamë kërkuar fjalën para se me marrë kryetari, kryetari e përmbledhi në tansi po dashta me u ndal 20 sekonda te temat e bujqësisë, cilat u ngritën me shumicë. Në kushte normale, dita kur votohet buxheti është një prej ditëve të shënime dhe t'ëndësishme të një komune si ne aspektin ekzekutiv, po ashtu edhe të kuvendit komunal, e ky buxhet që e kemi përpara, po besoj që është një prej lajmeve të mira edhe të gëzueshme për qytetarët e komunës së deçanit. Sa i përket aspektit të temave të bujqësisë për 3 vite, komuna e deçanit ka ndihmu me mekanizëm 400 fermerë për 3 vite janë ndihmur me 100 fermer me 100 krerë lopë qumështore. Javën që vjen hapet thirrja për 50 sera për fermerët tanë, ndërsa fillimin e vitit që vjen fillojmë edhe projektin e kanaleve të ujitjes që është në vlerën e 1.600.000 euro. Sa i përket subvencioneve 100.000 euro, ashtu siç ka marrë vendim kryetari do shkojnë për mekanizëm bujqësor që do të ndihmohen edhe 200 fermerë të tjerë. Pra, në aspektin e subvencioneve, dikund fermerët e deçanit rreth 400.000 euro do të ndihmohen po duke përjashtu aspektin e investimit kapital që do të jetë për kanalet e ujitjes, pra viti 2025 do të jetë 1 nga vitet më të mira sa i përket investimit në bujqësi në komunën e deçanit kjo iniciativë përpjekje angazhim i kryetarit të komunës së bashku me stafin e tij faleminderit shumë për fjalën.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor, drejtoreshë Dafina Cacaj e ka fjalën.

## Dafina Cacaj

Fillimisht po përgjigjem në kërkesën e komisionit që ju kanë drejtu për me shtu në projektbuxhet edhe projektin për furnizimin ose blerjen e tabelave të reja për emërim të rrugëve emrimet e vendbanimeve dhe numrat shtëpive. Projektet e vogla sikur kjo janë projektet që furnizohen 1 herë dhe janë projekte që janë ma të vogla për 1 njësi copë domethonë më të vogla se 1.000 euro dhe nuk hyn te investimet kapitale. Duhet të planifikohen mallra shërbime sikur mirëmbajtja sikur furnizimet edhe ky projekt nuk mundet me figuru në kapitale për këtë arsye edhe une pe marrë si propozim edhe ka me dalë tenderi në fillim vitit për me u furnizu me këto tabela duke bashkëpunuar edhe me drejtorinë e shërbimeve publike dhe me komisionin të cilin i kanë të dhënat në këtë po du mu lidhë edhe te kufijtë buxhetor edhe tek kategoritë që ndahen mallrat për drejtorin ose për secilin drejtor ose zyren e kryetarit kufijtë buxhetor nuk i caktojmë na, por me thonë unë po du me qitë në mallra shërbime kaqë ose subvencionet kaqë, ato na i cakton ministria na e bëjmë kërkesën, me na e rrit ose me na ul pak aprovohet apo nuk aprovohet, është prej atyne se mem ndëgu mu subvencionet nuk i kisha lën 350 po i kisha bërë 500.000 se na vyn ma shumë se sa shumë sene tjera se përkrahja për banorët ose për bujqësit edhe për krejt shkojnë në subvencione nuk shkojnë në kategori tjera, por kaq i kemi mundësitë dhe kaq është buxheti është shumë i vogël për deçan, po me këtë na duhet me punu me kaq sa kemi dhe me mujt me bo 1 zgjidhje sa më të mirë, te drejtoritë që e kanë të ndarë buxhetin nuk e kan me i shpenzuar punëtorë për veti, po i kanë me i kry shërbimet që i kemi ose obligimet për tenderët e ndryshëm sikur kjo që është furnizimi me tabelat duhet me u marrë parat ne drejtorin në të cilin i takon e jo me i marr unë ato para e me i qu në shpi se nuk më lejohet nëse janë për drejtor, janë për këto shërbime, ndërsa te numri i punëtorëve dhe numrin e punëtorëve nuk e caktojmë na po i caktojnë ministria është numri i puntorve që unë muj me bo kërkesë për me na rrit numrin për 1 arsye të veçantë që mundet me u aprovu në grante në komisionin e granteve por jo unë më thon i kom pas vjet 18 e sivjet i bona 21 ato në zyre te kryetarit qe jan rrit ose drejtorit tjera jan qe kemi bo levizje mrena drejtorive, qe jan kan numra te lir dhe ju ka dasht drejtrive te tjera qyky numer e kemi zhvendos nese u kan i lir por jo puntort me i rrit ose me i zvoglu sipas deshires nuk shkon te projektet kapitale, këto janë propozimet na e kemi mendu më së miri keto, normal qe mundemi me pas projekte të reja, për qef timin do ishin të gjitha të reja, por jan projekte në vazhdim edhe janë projekte që duhet me i përfundu dikush, nuk mundem un sivjet me fillu një projekte dhe me lën me fillu tjetrin nëse u planifiku në 2021 dhe është duke ju ardhur çdo herë çaje emer domethonë aj është projekt në vazhdim ai çdoherë duhet me u votu buxheti për atë sikur që votohet buxheti i përgjithshëm votohet edhe buxheti i asaj edhe nëse është 2 herë domethënë është faza e 1-rë dhe faza e 2-të edhe nëse shkruani i ri është projekt i ri jo Deçani i ri, por projekt i ri nëse është vazhdim un e kom bo per me jau lehtu punën juve me ditë cilat janë projekte në vazhdim dhe cilat janë rejat faleminderit.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtoreshë, atëherë ne duke ju falënderu për kontributin që dhat në diskutime e qesë në



votim projektbuxhetin për vitin 2025.

Kush është për?

Faleminderit.

A ka kundër?

Faleminderit

A ka abstenim?

Atëherë konstatoj që më 14 vota pro dhe 9 kundër komuna e Deçanit, kuvendi komunal e ka votu buxhetin për vitin 2025, vazhdoi me pikën e 3-të, që është raporti gjashtëmujor i punës realisht raporti gjashtëmujor i kryetarit të komunës materialin e keni pasur nga mbledhja e kaluar e hapi diskutimin nga grupi AAK Arjan Dobraj e ka fjalën a po Florim Mataj, Florim Mataj e ka fjalën urdhëroni Florim mundësisht ka një foni i nderum diçka te Arjani te Arjan Dobraj e ndezni mikrofonin dhe shiko dy mikrofone janë ndezur.

#### **Florim Mataj**

Faleminderit kryesues për fjalën te raporti 6 muaj i kryetarit nuk kemi diçka për me shtu si grup faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Veç me përgëzuar kryetarin për punën e mirë të jashtëzakonshme që e bën, faleminderit shumë nga grupi i Ldk-s Vatton Istrefaj.

#### **Vatton Istrefaj**

Faleminderit kryesues tek raporti gjashtëmujor i kryetarit ka qenë e paraparë që të raportohet për ne muajin korrik por për shkak se nuk ka ardhur askush për ta mbrojtur pikën e komitetit politik, financa na e kemi larguar nga rendi i ditës atëherë kurse mundemi me diskutu tani unë tek raporti i punës së kryetarit isha ndal vetëm tek nja 3 premtime kështu që kanë ma serioze për mendim timin për komunën e Deçanit një prej tyre ka qenë performanca komunale, ku kryetari në fushatë elektorale ka thënë se do të dal i 1-ri për performancë komunale ne renditjen e komunave, lëre qe ska dal i pari e as i pesti po pothuajse ka dal i fundit. Po ashtu ka premtuar subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ku ka ndodhur subvencionimi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme tjetër pikë është punësimi i të gjithë të rinjve kështu bukalisht gjithë të rinjve me kualifikim për punësimin e tyre kur ka ndodhur punësimi i të rinjve në komunën e Deçanit, pos nëse dikush ka marrë ndonjë kontratë kështu të jashtëligjshme mes atyre 51 kontratave që keni pasur më pare, edhe një projekt tjetër që s'ka nisur nuk e di qysh e ka premtuar kryetari ndërtimi i liqenit akumulues për hidrocentrale ishin kanë këto kater tema kryetar që kisha prit përgjigje nga ti faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë nga Vetvendosja nga Pdk-ja? Mon Selmanaj urdhëro

#### **Mon Selmanaj**

Faleminderit kryesues unë në shej të pakënaqësisë që nuk mora përgjigje nga kryetari dhe drejtoresha e buxhetit për buxhetin refuzoi të debatojë për këtë pikë.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë dikush tjetër, kryetar a ke diçka me shtu ose e kalojmë në rregull kryetarit Bashkim Ramosaj ja ndezni mikrofonin.

#### **Bashkim Ramosaj**

Për raport pune diskutimi ka të bëjë me këtë raport qe ka në të në rast se dojm me u shty politikisht e me argumentu i vjen koha edhe kësaj pune, në rast se dojm me fol popullizma nuk jom idhtar i deklarimeve të kota dhe temave të parëndësishme dhe po ashtu nuk kam ndërmend me ra nën ndikimin ose nivelin e e disa gjanave që dikush mundet me i përsërit, ripërsërit me i thanë me i rithanë e pa e ditë qysh argumentohen, unë e mbaj mend qe kam thanë edi qe kam premtuar e di sa jamë përgjegjës për atë që e kam than për ata që e kam realizu dhe për ata që nuk është realizu dhe po besoj që i vie koha ku qytetart janë ata që kanë me na gjyku, shumë mir qe vjen kjo kohë kaq.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë kryetar a e përfundove?

Në rregull a ka dikush tjetër Albesa Cacaj e ka fjalën.

### **Albesa Cacaj**

Vetëm dashta me marrë fjalën në lidhje me mënyrën e kthimit të përgjigjeve që e ka kryetari, kryetar ti je i zgjedhur po edhe ne përfaqësojmë asamblenë komunale të cilët jemi të zgjedhur nga qytetarëve kështu që tu kisha lutë konsiderat dhe rrespekt me na trajtu me njerzillëk dhe me rrespekt thjesht nëse nuk donë me u përgjigj në rregull, po jo me mungesë rrespekti faleminderit.

### **Hajdar Sutaj**

Albesa nuk ka dert ndonjëher edhe ne folim kështu a ka dikush tjetër diçka po kryetari e ka fjalën.

### **Bashkrim Ramosaj**

Jemi në mbledhje të asamblesë komunale ku rendi i ditës është i përcaktum jemi duke folur për raportin e punës nuk jemi tu fol për debat politikë nuk jemi në fushatë zgjedhore, jemi duke folur për një raport të punës në raport të punës i cili është i prezentum dhe tash qysh ka mundësi na dalim nga kjo temë dhe flasim për disa tema krejt inferiore

### **Hajdar Sutaj**

Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën.

### **Miftar Ahmetxhekaj**

Faleminderit shumë realisht nuk e pata në plan me diskutu, megjithatë nëse jemi te raporti i punës në raport të punës, i keni prezantuar 2 projekte të cilat janë në vazhdimësi po flasim për ndërtimin e fshatit turistik Podi i Gështenjës dhe për cilën vazhdimisht i kam ngrit dilema është ndërtimi i shtëpisë alpine, për të cilën kom thonë edhe njëherë që është dashtë me pasë shumë kujdes për shkak të emërtimit që e ka. Pyetje konkrete kryetar prapë janë në vazhdimësi kur do të përfundojën dhe kur është epilogi i këtyre 2 projekteve dhe nëse ka mundësi një kosto financiare për të dyjat veç e veç me na dhanë edhe për Podin e Gështenjës edhe për shtëpinë alpike kur do përfundojë për shkak se për të parën veç e di që ka qenë 1 projekt tjetër, po flasim për shtëpin Shkelzen Haradinaj për vlerësimin tim ka qenë 1 projekt tjetër dhe për cilën ato pyetje do ti shtroj më vonë, kur të vie koha, faleminderit shumë.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Miftar, kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

### **Bashkim Ramosaj**

Jemi duke folur për diçka që është publike që ka kontrat të lidhura përmes zyrës së prokurorit, e për cilat shifrat nuk mundem me i ditë përmendsh, mirëpo që janë kontrata krejt publike janë të shpallura, janë të publikuara, dhe janë projekte në vazhdim, sepse ka fillu me një projekt dhe unë jam tepër i lumtur dhe ndihem tepër i përmbushur që po krijohen 12 produkte turistike mbrenda shtëpisë bjeshkatore alpine Shkelzen Haradinaj dhe njëkohësisht jam tepër i lumtur dhe tepër i përmbushur për Podin e Gështënjeve për qendrën për koloninë e artistëve për qendrën rinore ,për pishinën gjysëm olimpikë për sallën e fitnessit dhe për krejt këto aksesori të cilat po bëhen aty dhe fillojn edhe nja 2 ndërtime tjera po në atë kompleks do me thanë janë projekte të gjalla të cilat nuk e di a kanë me u ndalë edhe nja 10 vjet duke funksionuar dhe duke u përmbush me produkte tjera që janë të nevojshme për këtë qytet kaq.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë kryetar të përgëzojmë për punën për angazhimin dhe të urojm punë të mbar dhe suksese të mëtutjeshme ju dhe gjithë neve vazhdoj me pikën e 4 është shqyrtimi i raportit gjashtëmuor të komitetit të komuniteteve, po ashtu materiali është nga mbledhja e kaluar, kush nga ky komitet është prezent që të diskutohet ky raport po.. po po nuk ka problem në rregull nuk ka problem faleminderit kush e mbron ose kush e diskuton temën e komitetit të komuniteteve, ju jeni anëtare Albesa nuk po e di kush është këtu në rregull mundesh me fol

### **Albesa Cacaj**

Unë nuk jam përgjegjëse sot për të mbrojtur temën, por e di që kryesuesi ka pas me qenë prezent, siç e dini dhe herën e fundit kur e kam njoftu, por për arsye shëndetësore ka njoftue se nuk mundet me qenë dhe shpreh shumë keqardhje kaq.

### **Hajdar Sutaj**

Në rregull atëherë kjo nuk është obligative që na me votu me diskutu a doni me diskutu ndonjë gjë për këtë raport në rregull e kalojmë jemi te pika 5, shqyrtimi dhe miratimi i raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore është kolegia është zyrtarja nga komuna gjegjësisht nga drejtorja e shërbimeve publike, Gentiana Mazrekaj urdhëro.

#### **Gentiana Mazrekaj**

Pershendetje për të gjithë i nderuar kryetar, drejtor.

Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera i formuar nga kryetari i komunës, ka përpiluar raportin rreth dëmeve, rreth vlerësimit të dëmeve materialin veç e keni pranuar, kjo më shumë si procedurë që duhet të kalohet dhe i njëjti material të dërgohet te komisioni qendror në Prishtinë gjatë vitit 2024 e kemi pranuar 41 kërkesa ku 39 nga to janë pranuar ne si komision kemi dal në teren kem shiqu i kemi fotografi i kemi përpilu dhe pas vlerësimit të gjendjes, komisioni e ka konsideru të nevojshme ose të arsyeshme që 2 rastet nga 41 të mos pranohen për shkak të sëmundjes cilat ata i kanë paraqit nuk konsiderohen si dëmet nga fatkeqësitë natyre.

#### **Hajdar Sutaj**

A e përfundove?

#### **Gentiana Mazrekaj**

Normal qe po

#### **Hajdar Sutaj**

Në rregull, shumë mire, a ka dikush diskutim? Meqenëse a dëshiron ndokush nga grupi i Aak-ës me folë në raport me dëmet nuk ka të lajmruar Miftar Ahmetxhekaj në rregull a je në emër të grupit në rregull faleminderit.

#### **Miftar Ahmetxhekaj**

Në Ldk jam unë kryesues besoj që e ke të qartë faleminderit shumë, atëherë edhe para disa seanca e nderume kemi pasë përafësisht pak të njëjtin problem nuk ka diskutim që nuk duhet mbështetur fermerët absolut as që e vë në diskutim ose në dilemë problemin e kem te raportet e para kur ka vendim është rregull dhe është mirë që komisioni i cili është emëruar me vendim ti ketë emrat, është njëfar rregulli kështu që secili raport me vendimin e datës kështu komision me përbërje kryesuesi dhe vazhdojn anëtarët e dyta pa të keqë unë kurrë nuk flas për emra flas për fenomenet duhet pajisjet me fotografi është 1 rregull kulturat, sasia, fotografitë nuk mundesh raporte të cilat vlera e tij është koxha vlerë e madhe dhe vetëm me emërtime, emër, mbiemër, grurë, kaq edhe përfundon.

Na duhet ta shohim thjeshta atë saktësinë e dëmit nuk e vë në dyshim që ju... nuk është e saktë absolut jo, por raporti që dikush me pa ma vonë është raport gjysmak është raport thjesht nuk vleresohet si raport kaq apsolut nuk e vë në dyshim që duhet me u mbështet faleminderit shumë.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë dikush tjetër Orgesi, Orges Tafilaj.

#### **Orges Tafilaj**

Faleminderit kryesues ne si grup e përkrahim këtë raport me gjithë vërejtjet që i përmendi Miftari dhe njëkohësisht urojmë që fermerët të kompensohen për dëmet e shkaktuara.

#### **Hajdar Sutaj**

Po drejtori i shërbimeve publike Izet Zanuni e ka fjalën.

#### **Izet Zenuni**

Vetëm një sqarim dashta rreth.. secila palë që ka paraqit kërkesën do të thotë nga 41 në 39 që janë aprovu nga komisioni të lajmruar nga kryetari secila e ka dosjen e veçantë me foto me përshkrim të situatës çfarë lloj fatkeqësie natyrore ka qenë, do të thotë është një dosje për secilin veç e veç ato dosje të njëjta ju dorëzohen komisionit qendror për vlerësim të dëmit dhe të cilat kalojnë edhe një herë aprovimin në nivel qendror. Deri më tani të gjitha rastet që kanë shku nga komuna e Deçanit, të gjitha janë aprovuar përjashtim të rasteve të ariut që ka bo dëme ne disa fusha që nuk hyjnë në kategorinë e ligjit mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Do të thotë secila prej komunav të Kosovës ..Deçanit do të thotë asnjë rast nuk u refuzu deri

më tani për arsye të vlerësimit të saktë dhe korrekt kanë qenë shumë reale dhe profesional në vlerësim kaq kasha.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë atëherë ne.. Hyrije a don me fol në rregull Hyrije Dobrunaj e ka fjalën.

#### **Hyri Dobrunaj**

Në mbledhjen e fundit të Kpf-ës këto kërkesat që i bëni Miftari edhe ne kemi kërku me pa dosje sepse për me u plotsu një kësi lloj kërkesë duhet edhe dosja e secilit veç e veç, mirëpo na kanë thënë që i kanë të kompletume, i kanë dërguar në ministri ne jemi për me mbështet e kemi thënë edhe aty secili dëm që iu shkaktohet qytetarëve, mirëpo aty kemi hasë një problem, ku thotë se në ligjin për fatkeqësi natyrore nuk përfshihen dëmet nga arinjte përshembull e që në komun të Deçanit ka mjaftushum ndoshta ish dasht me shiqu një iniciativ për ndyshimin ose plotsimin e këti ligji që me futë në kategorin e dëmeve fatkeqësive natyrore sepse ariu është i mbrojtur me ligj, në qoft se është i mbrojtur me ligj atëher ish dasht edhe dëmet nga ariu mu kompenzu, këtë e kemi thënë edhe atë ditë edhe sod nuk kemi diqka tjetër me shut e mbështesim.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shum a kenë me shtu diqka e nderume drejtori Izet Zenuni e ka fjalën

#### **Izet Zenuni**

Kam kërkuar zyrtarisht te komisioni qendror që të na interpretojnë një form se në cilën kategori futen dëmet që shkaktohen nga ariu 2 kategori këta nuk i futin në fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera, kategorin e zjarreve dhe në këtë kategorin si ne rastin si Deçani që e ka ariun që ka bërë dëme në raste të caktume, kemi lyp interpretim ligjor dhe cila fushë e mbulon këtë dëm, ende nuk kemi marrë përgjigje zyrtare me shkrim presim momentin që na orientojnë në cilën kategori futet, ne kemi me u marr edhe me keto rastet tjera.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë drejtor atëher e qes në votim raportin.

Kush është për?

A ka kunder?

A ka abstenim?

Konstatoj që në mënyr unanonime kuvendi i komunës e ka miratuar raportin e dëmeve të fatkeqësive natyrore edhe përgëzoi edhe drejtorin dhe drejtorinë përkatëse për punën që e kanë bërë, një pauz 15 minuta 11:15 është 11:30 jemi në seanc.

#### **Hyri Dobrunaj**

Në harmoni me ligjet në fuqi në republikën e kosovës kur bëhet fjalë te formimi dhe përbërja e komisioneve, kryetari i komunës nuk nxjerr vendim për formimin e komisionit sipas ligjit, komisioni formohet nga anëtarët e asamblesë dhe të tjerë kryetari i komunës vetëm jepë sqarime për dhënien e pronave në shfrytëzim një vjeçar, interesin për komunën dhe raportin në fund çka ka ndodhë mirëpo nuk themelon komisione sipas ligjit në fuqi kjo është vërejtja ime. Besoj që edhe Miftari ka me shtu diqka dhe Albsat gjithashtu faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë nga Vetvendosja Nuk ka, nga PDK- ja nuk ka, tjerë të lajmrum Albesa Cacaj

#### **Albesa Cacaj**

E mbështet diskutimin e kryetares së grupit, njëjtë mendoj që në bazë të ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komisioni duhet të përbëhet prej 3 ose 5 anëtarëve e jo të zgjidhet nga kuvendi i komunës, gjithashtu edhe komisioni ankesa zgjidhet, mandatohet edhe shkarkohet nga asambleja komunale e jo nga kryetari.

Tjetër ende se kam përfundur në rregull në nenin 14 te pika numër 2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës apo shmangies nga qëllimi për të cilin është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatisë raport përfundimtar me të cilin do të rekomandojë kryetarin e komunës për shkëputjet e njëanshme të kontratës, pra drejtoria rekomandon kryetarit te komunës dhe kryetari obligohet

që në raportet e tij të rregullta gjashtëmujore ti paraqesë kuvendit komunës edhe raportin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave të përmbushjes së qëllimit dhe dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, pra a janë tu e përmbushë ose tu e realizu qëllimin pronat cilat i jep komuna këto janë vërejtet e mia.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë Faton Selmanaj.

#### **Faton Selmanaj**

Faleminderit kryesues, unë e pata një pyetje pak jashtë rregullores kështu po që lidhet me rregulloren a mundeni me na njoftu kryetar se sa prona ka komuna që mendon me i jep në shfrytëzim apo me i këmbë përderisa po flasim për këtë rregullore.. ndoshta nuk është po veq jemi duke bërë rregullore për atë punë, kështu që veq si informatë nëse ka.. nuk po themë unë me u lëshu në detaje tash kështu ose me jep kumdeit çfarë informacione të detajume.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, drejtori i shërbimeve publike Izet Zenuni e ka kërku fjalën.

#### **Izet Zenuni**

Gjithmonë duhet me pas parasysh se është rregullorja që jepen pronat më pak se 1 vit në shfrytëzim, do të thotë, me gjitha pronat që jepen më pak se 1 vit është kompetencë e kryetarit, pronat që jepen 1 vit deri 20 vite, 20 vite deri 99 vite është që kalon përmes asambles dhe formimi i komisioneve edhe raporti e të gjithë gjanat tjera. Këto janë prona që jepen qoftë për një muaj qoft për 2 muaj qoft deri në një vit më së shumti dhe në qoftë se ne mundemi me tejkalu, ndoshta donjë normë ligjore që nuk mundemi me përfshi kjo shkon në nivel qendror nivel të ministrisë, e cila e merr ligjshmërinë, dhe na kthehet prapë në qoftë se e kemi shkel ligjin, na kthehet me rekomandime dhe e bëjmë ndryshimin. Gjithmonë jem duke folur për pronat që japën më pak se një vit në shfrytëzim qoftë për stenda, qoftë për verë diçka aktivitet tjetër po, kjo është.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë Hyrije a pate diçka me shtu apo jo?

#### **Hyri Dobrunaj**

Marr dikush personale me thonë jo jeni arrogant ose jeni kështu e ashtu me pyet. Kur e patëm fjalën te raportimi i kryetarit për shembull e kamë një pyetje pa takt na e kemi dhënë edhe fabrikën e mjaltit në shfrytëzim 15 vite kurr askush nuk ka raportuar këtu askush, ku shkojnë ato para as nuk janë pasqyruar kurrë në pasqyrat financiare të komunës e që janë 600 euro për çdo muaj, kjo është një diçka e vogël e kemi plot të tjera nuk është raportuar kurrë për asnjë gja tjetër e për këtë edhe kjo lidhet me rregulloren që duhet rregullorja me u bë nga kuvendi, për me pas raport më transparent. Kisha dashtë me ditë dhe sot qe sa vite e shfrytëzon dikush fabrikën e mjaltit ne nuk e dim as destinacionin ku ju ka dhën as ku shkojnë ato mjete, as kurgjo qka ndodh

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, dikush ne lidhje me draft rregulloren a ka diçka? drejtor a ke diçka me shut? e qes ne votim draft rregulloren.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

I kemi 6 vota të cilat janë abstenim e kundër nuk është asnjë edhe i kemi 17 vota për e kemi kalu draft rregulloren për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në periudhën deri ne nje vit. Jemi te pika e 7 është shqyrtimi i draft strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje 2024-2027 prezantimin deri në 3 minuta e ke e nderume mundesh me shfrytëzu foltoren e pastaj po në rregull 3 minuta diskutim ka propozuesja dhe hartuesja faleminderit

#### **Ajne Ibërhyasaj**

Përsëhendetje të pranishëm i nderuar kryesues, kryetar, anëtarë të asamblesë. përfaqësues nga OSBE-ja, ekzekutiv.

Atëhere 3 minuta kohë në rregull 6 minuta.. 6 muaj që më ka marrë mu atëherë themelimi po fillojmë historikun.

Themelimi i mekanizmit kundër dhunës në familje është bërë në vitin 2023 pjesë e këtij mekanizmi ka qenë edhe hartimi i këtij dokumenti, ku në këtë dokument pjesën strategjike e kanë punuar anëtarët e grupit të mekanizmit, ku janë përfaqësues 16 institucione sipas ligjit kundër dhunës në familje kanë përgjegjësinë e tyre. Të dhënat pjesë strategjike janë marrë pikërisht nga anëtarët e mekanizmit, plani i veprimit kundër dhunës në familje është punuar nga grupi punues, i përbërë nga anëtarë të asamblesë nga ekzekutivi, atëherë struktura e këtij dokumentit, i cili përfshin hyrjen, qëllimin, objektivat, synimet, analizën e gjendjes duke u bazuar pikërisht në të dhënat që kanë afruar komandanti i stacionit të policisë, udhëheqës i zyrës së personelit të komunës, të cilat i keni te analiza e gjendjes problematike, të cilat kanë të bëjnë të ballafaqohet komuna deçanit me këtë problematikë e të dhënat që janë marrë nga kryetarja e gjykatës nga qendra për punë sociale kjo është pikërisht 1 prej çështjeve të cilat duke u bazuar në të dhënat që kanë afruar, kemi pikërisht rritje të rasteve të dhunës në familje sipas viteve 2021,2022,2023, duke referuar gjithmonë të dhënave të komandantit të stacionit policisë, gjithashtu gjykatës themelore dega në deçan, që është pikërisht anëtare e këtij mekanizmi. Fushat e veprimit shtojcat që është plani i veprimit janë të specifikuar aktivitetet kohëzgjatja është 4 vite dikush duhet të ma matë me kronometër, pak a shumë kohë ta di se a janë 2 minuta a 3. Atëherë i gjithë ky proces i finalizimit të këtij dokumenti është pikërisht periudhën 4 vjeçare me një shumë të matshme, të arritshme gjithmonë që e ka pikërisht kemi parapa të arsyeshme 28.000 mijë euro. Shpresoj që do të ketë mundësi dhe përkrahje mbështetje që bëhet implementimi i këtij dokumentit, kështu që plotësohet pikërisht dokumentet që kanë të bëjnë me zyrën e kryetarit, zyrën e barazi gjinore, që është 1 prej dokument shumë të domosdoshme të rëndësishëm, faleminderit sa mbeta borq sa më mbetët borq faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë nga grupi i AAK-ës Arian Dobraj

#### **Arjan Dobraj**

E nderuara Ajne të përgëzoj shumë për punën e gjatë dhe të mundimshme që e ke bërë në fakt në mesin e shumë diskutimeve për dokumente të ndryshme që na ka ra me diskutu dhe me punu bashkë e vlerësoj shumë e çmoj shumë seriozitetin tënd që e ke në përpilimin e dokumenteve dhe gjërave të tilla, sikur ajo që ke sjellë sot ne vetëm përgëzojmë për punën e jashtëzakonshme që e ke bërë te urojm suksese në realizimin e objektivave faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Falemnderit shumë nga LDK-ja Hyrije Dobrunaj.

#### **Hyri Dobrunaj**

per të përgëzojmë edhe duhet me të komplimentu, sepse jo vetëm na po ka njerëz edhe jashtë, jashtë këti rrethi që më kanë pyet asht njeri më punëtore dhe me e menqura Ajna në komun sepse gati krejt strategjit duhet me i punu kështu që më kanë pyetur shumë të përgëzojm për këtë, mirëpo më vjen keq që ti nuk je përgjegjëse për me i çu deri në fund këtu përgjegjësit për me i çu deri në fund këto plane te veprimit janë kryetari dhe komuna menjëherë kur ka implikime buxhetore e di që kjo nuk shkon deri në fund dhe po më vjen keq edhe prej vetvetës se e pash edhe sod përshebull edhe tek diskutimi për buxhetin që është e kotë nëse e diskuton sepse këta e kanë avazin e vet dhe nuk mërziten ai buxhetin nuk e ka paraparë, nuk ka parapa barazi gjinore, nuk ka paraparë ndonjë projekt më të madh për gratë ose kështu që komuna jonë nuk është e interesume në këtë drejtim besom që nuk është fare e din edhe ti na nuk kemi as zyre për barazi gjinore që edhe ligji e kërkon e parashih pranë zyrës së kryetarit, nuk i kemi asnjë prej tyne, kështu që të përgëzoj për punën, mirëpo implementimi i kësaj sod jam e bindur që ka me qenë zero.

#### **Hajdar Sutaj**

Nga Vetvendosjes Orges Tafilaj.

#### **Orges Tafilaj**

Faleminderit kryesus, Ajna të lumt për punën që e ke bërë megjithatë realizimi i kësaj strategjie, ne të gjithë do të dëshironim që të bëhej qindë për qindë. Fatkeqësisht për tu realizuar është.. duhet të jetë një bashkëpunim i mirë mes shumë hallkav më shumë institucioneve dhe normalisht që mungesa e një hallke ose moskryerja e punës së një hallke do të ndikojë që komplet zinxhiri të dështoj dhe në anën tjetër po ashtu pjesa financiare besoj që ka me qenë problem dhe krejtësisht në fund sinqerisht a besom që do realizohet kjo strategji deri në fund apo jo?

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, Mon a don me shtu diqka, Mon Selmanaj e ka fjalën.

**Mon Selmanaj**

Unë nuk kamë qfar ti shtoj këti dokumentim e mbështesë në tërësi me dëshirën më të madhe që kostoja e kësaj draft strategjie të implementohet deri në centen e fundit me shpres gjithmon faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Falemnderit shumë a ke me ju pergjigj këtyre diqka, nëse ke mundësi mikrofonin te Ajna

**Ajne Ibërhyasaj**

Faleminderit për minutat te cilët më kan mbet dhe po i shfrytëzoj 3 minutshin, por gjithsesi falenderoi secilin për fjalët e mira dhe për motivin, por megjithatë kjo shkon gjithmonë për zyrën e barazisë gjinore, për të cilën unë jam duke përfaqësuar deri më 2 shkurt, ku kolegja do të dalë në pension. Kemi bërë një hap të cilin gjithmonë duhet të bëjmë edhe më shumë, sepse pajisja hartimi i këtyre dokumenteve është një domosdoshmëri, më mirë që i kemi dhe më mirë do të ishte dhe po mos të ishin do të ishte edhe më e mira e të mirës se nuk po shkoj në atë të kundërtën. Por megjithatë hapat e mëtutjeshme të politikave të barazisë gjinore janë në koordinim, qoftë në nivelin qendror, gjithashtu me nivelin lokal dhe të cilat parashihen në këto dokumente strategjike që kemi realizuar brenda këtyre 2 viteve, vjen koha që do të jenë edhe implementuar dhe mbështetur edhe me buxhetim, kështu që shpresoj gjithmonë në të mirën e të mirës, falemnderit shumë.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë Albesa Cacaj u lajmru pastaj Arian Dobraj

**Albesa Cacaj**

Përshëndetje dhe njëher, përgëzime për punën e pafund që e bën kolegja, jam skeptike në realizimin e kësaj strategjie sepse e nderuar e di që e ke parasysh se kur bëhet një draft strategjie ajo ka edhe koston buxhetore. Doja të dija a je konsultu me mekanizmat me zyrën e kryetarit, drejtorinë e financave paraprakisht se ku do merren mjetet buxhetore nga cila kategori për tu realizuar ky plan sepse e kemi edhe planin komunal për barazi gjinore, i cili u miratu vitin e kalum dhe në fund, janë objektivat që janë parapa sigurse te kjo strategjia tjetër janë parapa të cilat do arrijnë brenda vitev, janë vitet specifikume 2023-2024 dhe deri më tani nuk kemi, edhe pse u parapa edhe në planin e punës te asambleistet 1 raport që duhet ta sjellë kryetari i saj a janë realizu objektivat qëllimet dhe kjo nuk ka ndodhë, domethanë a jeni konsultu paraprakisht se ku dhe nga cila kategori do merren mjetet buxhetore që të realizohet, sepse ne e kuptojmë rëndësinë, po e kuptojmë edhe ata që formalisht ti kemi këto draft strategji, por suksemi më i madh mos të harrojmë është realizimi i tyre faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit Arian Dobraj.

**Arjan Dobraj**

Se mendova se e përfundova po vetëm deshta me u ndërlihd skepticizmin e opozitës nuk kena nevojë këtu me u shfaq vetë fakti se jemi para kamerave me vu në dyshim gjithmonë punën këndeje po e përgëzojn e këndeje po e vën në dyshim punën e zonjës Ajne bashkë me angazhimin e kryetarit. Përderisa kryetari është angazhu nga fillimi në mbështetjen e këtij draft dokumenti edhe normal me angazhimin i tij prapë edhe me vartësit e tij do të realizohet dokumenti, ashtu si i ka synimet dhe objektivat faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë nuk tu ka përmend emri më vjen keq, a ke diqka me shtu

**Ajne Ibërhyasaj**

Faleminderit për pyetjet për gjithqka unë jam caktuar nga kryetari i komunës, koordinatore për mekanizmin kundër dhunës në familje. Gjithashtu koordinimi është bërë me anëtarët e mekanizmit, me datën 13 shtator kemi mbajtur takimin ku pjesë e këtij takimi kanë qenë edhe anëtarë të asamblesë të grupit punues. Sa i përket politikave, të cilat kanë të bëjnë me buxhetin, megjithatë këtë vit 2024 është hartuar ky dokument dhe për vitin 2025 atëher fillon procesi i të cilit duhet të merren planifikimet që janë paraparë në këtë draft dokument. Gjithashtu, dokumenti është për dhënien e vrejtyev plotësimeve janë edhe anëtarët përgjegjës, anëtarët e mekanizmit, atëher anëtarët e mekanizmit tonë unë po i ceki secilin është zyra e kryetarit të

komunës, të cilën përfaqësoj unë dhe si përfaqësuese me vendimin e kryetarit që jamë e caktuar, si ushtruese detyre e barazisë gjinore dhe prokuroria që është e përfshirë gjithashtu është stacioni i policisë, komandanti stacionit të policisë, mbrojtja e viktimave në deçan, gjykata themelore në Pejë dega në deçan, kryetarja e gjykatës, zyra për ndihmë juridike falas qendra për punë sociale, zyra për barazi gjinore, qendra për shëndetësi mental, drejtoria komunale për arsim, drejtoria komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale që janë qendra e mjekësisë familjare, zyra komunale për komunitete dhe kthim strehimorja pejë, drejtoria për kulturë rini dhe sport dhe drejtoria e arsimit. Ky është anëtarët e mekanizmit, gjithsesi pa kordinimin e këtyre nuk mund ta sillja deri këtu këtë draft dokument dhe pjesa tjetër që është plan i veprimit, sepse çdo strategji duhet të ketë edhe konkretizimin që ka të bëjmë në formë tabelare që specifikohen veprimet, aktivitetet dhe duhet të jenë me një kohë të matshme me linja buxhetore, unë jam shku në atë formën të cilat edhe grupi punues që kemi punuar dhe kam lehtësuar se pak a shumë, sepse gjithmonë draftet e para nuk është e lehtë të i punoj, por është.. pres mendimet, sugjerimet, plotësimet, secilit anëtar, i cili është pjesë e grupit punues, sa mund të jenë për në këtë drejtim, u tha që nuk ka zyrë të barazisë gjinore meqenëse unë jam që 2 vite dhe nuk ka rëndësi vendi se ku je, faktikisht është mënyra e veprimit dhe mënyra e kryerjes së punëve të cilat besohen, kam marrë këtë përgjegjësi deri më 2 shkurt, të cilën është plotësu pikërisht me dokumentacion, duke u bazuar në infrastrukturën ligjore, qoftë barazi gjinore, qoftë edhe mekanizmat, të cilat kanë të bëjnë kundër dhunës në familje, por gjithmonë gjithnjë në koordinim me zyrën e kryetarit dhe politikën, të cilat drejtohen nga kryetari i komunës falemnderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Falemnderit shumë Ajne e ka fjalën Vaton Istrefi e ka kërku.

#### **Vatan Istrefi**

Falemnderit për fjalën kryesues sa i përket rregullores ne patjetër që e përkrahim të japim propozimet tona, por sa i përket asaj që e kemi si skeptik pra nuk është hera e 1-rë që rregulloret janë vetëm si obligim strategji këto strategji janë vetëm si obligim dhe mbesin aty për shkak të komplikimeve financiare që i kanë. Kjo vjen si arsye e projektbuxhetit në shumicën e rasteve të pamirëfilltë, si për shembull gjysmën e 1-rë të vitit janë marrë 4 milion euro. Çfarë ndihmese mundet me i bo kryetari i komunës kësaj strategjie, kështu që na nuk rruojm per kamera Arian nese rrnon dikush le të fol për veti.

#### **Hajdar Sutaj**

Falemnderit shumë po Miftar Ahmetxhekaj

#### **Miftar Ahmetxhekaj**

Falemnderit shumë kryesues meqenëse urime dhe përgëzime morët mjaftueshëm, po ju kursej vetëm pyetje konkrete. Projekt strategjia e ka një kosto financiare a je konsultu ose a ke marrë zotim? sod seanca veq e kaloj buxhetin për vitin 2025-2027 thjesht a ka mjete te zotume shum e thjesht është, konkret ka ose nuk ka.

#### **Ajne Ibërhyasaj**

4 që e përfshin hartimin e dokumentit dhe miratimin e tij fazat e implementimit dhe mbështetje buxhetore fillojnë në vitin 2025 sepse është faza, sepse tetor nëntor, nëntor kam fushatën e 17-të ditshit kundër dhunës në familje që fillon prej datës 25 nëntor deri me 10 dhe aty do të ketë implikime buxhetore që duhet zyra e kryetarit për me nda mjete dhe kjo është fati e pikërisht fati i 1-rë që do të paraprijë me implikime buxhetore për vitin 2025 ishalla jemi shëndoshë e mirë dhe shpresoj që....

#### **Hajdar Sutaj**

Kolegë kjo draft rregullore draft strategji komunale për mbrojtje nga dhuna në familje do të jetë diskutim publik në 30 ditët e ardhshme falemnderit per kontributin, falemnderit Ajne  
Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që në mënyrë unanime kuvendi komunal i ka hap rrugë diskutimit publik të kësaj draft strategjie. Jemi te pika e 7 që është njoftim i drejtorisë për arsim për përgatitjen e vitit shkollor 2024-2025 dhe ja kaloj fjalën drejtorit për arsim, zoti Besnik Hulaj drejtor fjala për juve mundesh me vazhdu.

#### **Besnik Hulaj**

Përhëndetje për të gjithë të nderuar kryetar, kryesues drejtor dhe ju asambleist.



Më lejoni të ju njoftoj se në shkollat në komunën e Deçanit mësimi ka fillu me 2 shtator, te gjitha shkollat janë pajis me te gjitha mjetet e nevojshme për fillimin e vitit shkollor e ngecje kemi pasur vetem me tekstet shkollore sa i përket shkollav te mesme e të ulëta e gjithsej komuna jon ofron 20 shkolla, 18 shkolla te mesme te ulta dhe 2 gjimnaze po ashtu kemi edhe 4 paralele te ndara besoj qe materialin edhe ne kopje fizike e keni te gjith përpara nëse ka nevojë diçka me shtu përpos këtyre që i kam cek në raport, unë jam i gatshëm me u pergjigj ne të gjitha pytjet.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë drejtoj prej grupit të AAK-ës a ka dikush diçka vetëm ka përgëzime

#### **Arjan Dobraj**

Normal kryesues kur kryhet puna mirë normal se ka përgëzime faktikisht e përgëzojmë edhe drejtorin Hulaj për sqarimin, po e kemi këtu dhe me shkrim siç e tha dhe vetë gjitha përgatitjet kanë nis me sukses për me nisi edhe viti i ri shkollor. Unë personalisht edhe vetëm jamë dëshmitarë që shkollat po furnizohen me mjete të ndryshme bashkëkohore, të cilat e lehtësojn edhe më shumë procedurat, në fakt zhvillimin e procesit mësimor, qoftë me mjete për kabinetet, qoftë me pajisje tjera, e paska cek që edhe në ditët në vazhdim fillon edhe furnizimi i shkollave me dru dhe pelet për ngrohje, kështu që nuk kemi diçka më shtu tjetër vetëm e përgëzojm për punën dhe i urojm suksese faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë nga LDK-ja Vatton Istrefaj.

#### **Vatton Istrefaj**

Faleminderit kryesues, përshëndetje drejtor dashta me bo një pyetje të cilën kemi diskutu pak edhe në komitet politik financa, çfarë po ndodh me furnizimin me dru pelet dhe ngrohje për shkollat e komunës së deçanit, ku e dimë se 1 tender për furnizim ka dështu edhe çka doni me marr tash si me shpejtësi pak themi ashtu se tetori erdh koha mundet me u ftof nesor faleminderit

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, nga Vetëvendosja Faton Selmanaj.

#### **Faton Selmanaj**

Drejtor pyetjet dhe komentet që i kom pasë i kom bo edhe në komision për politikë e financa po dua ti përsëris edhe njëherë lidhur me furnizimin e shkollave me dru pse ka dështu tenderi parë edhe në çfarë afate kohore mendon që të gjitha shkollat do të jenë të pajisuna me dru dhe pelet edhe komenti i 2-të është lidhur me problematikën që e kamë cekur edhe atë ditë, me konfliktet që janë duke pasur nxënësit edhe problemet e vazhdueshme kohëve të fundit dhe këtë ma shum po ta bëj si formë kërkesë për një bashkëpunim më të mirë me institucion policor që ndoshta në të 2 ndërrimet në shkollat e mesme është mirë me ju kërk policisë që pak më shumë me lëviz në rrugën e gjimnazit domethan rreth orës 12:30-13:00 dhe pas ores 5 kur nxënësit lirohen nga shkollat, faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Faton, Mon Selmanaj e ka fjalën.

#### **Mon Selmanaj**

Faleminderit kryesues, i nderuar drejtor un e kam një pyetje të dhënat që na i keni ofruar thuhet gjithashtu jemi në pritje të interpretimit të ndërtimit dhe adaptimit dhe të 4 çerdheve tjera, në cilën fazë të implementimit të tyre janë.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Mon, drejtor atëherë mundesh me u përgjigj në pyetjet e kolegëve.

#### **Besnik Hulaj**

Atëher faleminderit shumë për pytjet, po i pergjigjem pytjes së Vatton Istrefaj të njëjtën e ka bërë edhe Faton Selmanaj për furnizim me dru. Ne si komunë ose drejtori e arsimit e kemi bërë kërkesën me kohë për furnizim me dru, mirpo përmes prokurorit tenderat zgjasin 30 ditë lajmërim domethan 1 muaj dit lajmirim per

tenderim, mirpo pas konkurimit të kompanive kanë pas ankesa ndaj njëri tjetrit dhe normal afati ligjor që ka qenë ka rrjedh për me u ba ma shum se 3 muaj derisa u marrë një vendim për ta, vendimi është marrë me u hap tenderi edhe një herë për herën e dytë, besoj që ka dalë këtë javë brenda 20 ditëve kësaj pergjigje qe ju ka bërë përmes prokurimit dhe përmes OSHP-s. Furnizimin me dru tash brenda 20 ditëve kush pe merr është tender i hapur, kush pe merr atë furnizim dhe qdo herë furnizimi është bërë brenda 2 jave për të gjitha shkollat nga kompanit që i kanë marr përpara, besoj që është e njëjta punë edhe për tjerat. Ndërsa te pyetja e Fatonit për konflikte dhe siguri në shkolla, po është e vërtet që ka konflikte në gjimnaz nga gjimnazistët mirpo vazhdimisht ka jashtë rrethojave të shkollave apo jashtë objektit shkollor, edhe si kompetencë i kalon policisë. Mirëpo edhe bashkëpunim me policinë, edhe takimet që kemi qdo javë me policinë interesohem vazhdimisht që policia të jenë të njoftuar nëpër rrugen e gjimnazit po ashtu edhe mbartvajtjen dhe lirim in e trotuarëve nga veturat mirëpo ndoshta është e pamundur edhe për policinë që me pasë qdo gjë nën kontroll, por vazhdimisht jemi duke punuar me ta e vazhdimisht janë policia në rrugën e gjimnazit i kam lutur qe me patrollu pak ma shpesh duhet me pas edhe patrullime ne kamë, tash ta shohim veprimin e tyre.

Ndërsa te pyetja e Mon Selmanaj te ndërtimi dhe adaptimi i qerdheve, na kemi fillu nga 1 projekt i ministrisë për ndërtimin e qerdhes në fshatin Carrabreg faza e parë e ndërtimit të qerdhes ka përfundu tash ajo është si plan, është realizimi i saj e për 3 vite është nga ministria, e adoptimi i qerdheve ne kemi bërë kërkes në ministri edhe për ndërtimin e 2 qerdheve të reja në fshatin Strells dhe fshatin Gramaqel po ashtu adaptim në Isnqi dhe në Irzniq që në mënyrë që të mbulohet komplet rrafshi domethan komplet fshatrat e Deçanit të mbulohen me qerdhe mbas numrit të nxënësve që parashihet me marr pjesë me to, mirëpo kërkesat i kemi dorëzë jan pranë tash varet gjithçka prej ministris sepse janë projekte të ministrisë.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit drejtor Albesa Cacaj edhe Orges Tafilaj janë lajmruar për fjalë fillimisht Albesa Cacaj.

#### **Albesa Cacaj**

Në rregull atëherë i nderuar drejtor sa i përket anës së braktisjes së shkollimit nga nxënësit, nuk ka viteve të fundit e ke konstatu tek ky raporti, unë mendoj që është gabim.. ta themë ata që po du.. mendoj që e konstatu gabim për arsye dhe për faktin se ne si komitet për komunitete dalim vazhdimisht në hapësirat ku shkojnë vijojnë mësimin nxënësit nga familjet, nga komuniteti dhe kemi konstatu që ka ndërprerje të mësimit disa herë si drejtori ju kemi drejtuar dhe në mungesën tënde ka qenë i pranishëm zyrtari i arsimit, te cilin e kemi informuar, që ka ndërprerje të arsimit fillor, që është i detyrueshëm në republikën e kosovës dhe ju si drejtor i arsimit ose si ekzekutiv nuk keni ndërmarrë asnjë veprim. Pika tjetër është që doja të dija më shumë për çështjen që e keni caktu këtu është e ditur edhe ndërprerja e ndërtimit të shkollës së qytetit, pra shkollës e qytetit Lidhja e Prizrenit në Carrabreg ka vite që ajo shkollë ka fillu të ndërtohet në mos gaboj në vitin 2019-2020 punimet kanë stagnu asnjëherë nuk kemi pasur përgjigje se çfarë, se cilat masa ose cilat veprime janë ndërmar që projekti të vazhdoj përfundoi edhe fëmijët ta gëzojnë objektin me rezultate ma t'mira faleminderit.

#### **Hajdar Sutaj**

Drejtor a don me u përgjigj drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën

#### **Besnik Hulaj**

Faleminderit Albesa për pyetjen kem pasur vazhdimisht dhe është e vërtet se ti je edhe pjesë e komisionit te KPF-s ka pasur braktisje të kohëpaskohshme, por jo lëshim të shkollës, domethan problemin kryesor e kemi me minoritete për shkak që janë me social dhe 6 muaj e vazhdojn dhe 6 nuk e vazhdojnë kur vjen koha me vazhdu socialin e vazhdojn prapë por braktisje skem pasur, braktisje kemi pasur vetëm shperngulje ne botën e jashtme kemi pasur 12 fëmij dhe 3 nxënës 2023-2024 Ndërsa për ndërtimin e shkollës në Carrabreg shkolla e qytetit ka qenë një projekt që ka zgjat dikund 3 vjet mas pakti me ju nda një kontratë një punëkryesi. Mirpo nuk ka qenë ne doren as të komunës as të drejtorisë së arsimit, sepse ka qenë investim i ministrisë komplet edhe pas 3 viteve me datën 2 të këtij muaji janë hap tenderuesit janë hapë letrat e tenderave mirëpo dje kam pasur kontaktin e mramt me ministrin domethan janë qasje procedurale të letrav që ende nuk dihet fitusi mirpo edhe tenderimi ka perfundu direkt nga ministria , jo nga ne jemi interesuar shumë herë për këtë sepse shkolla nuk është në gjendje të mirë shkolla e Carrabregut dhe për atë arsyë është duke u bërë shkolla e re po tashë këto ankesat që kanë firmat mes vete këto nuk kanë qenë në OSHP as nga ne e as nga ministria Besoj se jemi në rruga të drejt dhe fillojm sivej implementimin të atyre mbetjeve që janë bërë me vazhdu prapë ta shohim.

#### **Hajdar Sutaj**

Orgesi pastaj Leotrimi

### **Orges Tafilaj**

Faleminderit kryesues i nderuar drejtor kisha vetem një qeshtje për të diskutuar, e kemi diskutuar shpesh ndoshta edhe vitin e kalim çështjen e pajisjes të shkollës Bush me një printer dhe një kompjuter, duke qenë pjesë e këshillit drejtues të shkollës, e kam vizituar shkollën edhe e kam parë gjendjen aktuale, fatkeqësisht një pjesë e madhe e mësimdhënësve që janë aty detyrohen që kopje ose printimet ti bëjnë në shkollën Isniq ose ti bëjnë me lekët e tyre a mundemi me marr një premtim drejtor kur mund të zgjidhet si çështje? Ose me kë duhet të diskutojmë që të zgjidhet një herë e mirë kjo çështje faleminderit.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Orges, drejtor a dëshiron me u përgjigj mas qdo diskutusi apo deshiron me i marr pytjet? Leutrimi, Leutrim Hadergjonaj e ka fjalën

### **Leutrim Hadergjonaj**

Drejtor dashta edhe një sqarim shtesë me na bo për land te drurit në bazë të procedurave të prokurimit ajo deri më 14 tetor nuk bëhet hapja e ofertave. Potencialisht 3 javë pas nuk ki drejtë me heret me nenshkru kontrat deri sa te perfundon vlersimi deri me 5 nëntor nuk kemi me pasur dru, në qoftë se shkon gjithçka mirë nuk bëhet ndonjë ankesë në OSHP që shkon tu e shty ajo edhe një muaj e nëse bëhet ankesa në komunë e shtyn procedurën edhe 10 ditë të tjera.

A e ke analizuar situatën me bo zgjidhje tjetër emergjente edhe a ki mundsi.. a janë të gjitha shkollat të pajisura me ngrohje qëndrore që i bjen me radiatorë? Ose a ka form tjetër për shembull të klimës për momentin me dasht me qitë pomp termike në qoft se nuk ke me pasur dru sepse hera parë qysh u shty ..u shty ankesë në OSHP 99% ki me pasë edhe tash ose më së largu me 5 nëntor ke me i pasë drutë këtu mos është pak vonë edhe a ke mendu ndonjë zgjidhje alternative tjetër.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë Hyrije Dobrunaj e ka fjalën.

### **Hyri Dobrunaj**

Edhe unë i pata disa pyetje më së pari përgëzime për gjendjen shumë të mirë që e kemi në arsim u tha këtu a është e vërtet apo jo më së miri e dinë qytetart e Deçanit ku dhe unë e pata një pyetje pothuajse të ngjashme me pyet drejtorin, a e keni menduar ndonjëherë ngrohjen termale nëpër shkolla këtu ku doni dru e pelet nuk kushton më shtrejt as ngrohja termale është alternativë shumë e mirë. Pastaj te paraqitja e diferencës për nxënës e kemi pa te shkollat e mesme keni paraqit prej vitit në vit ramja ose ngritja, mirëpo te shkollat fillore nuk kemi parë edhe kjo kish me qenë mirë me u pa sepse besoj keni statistika në atë drejtim me pa sa është ramja prej vitit në vit prej klasës së 1-rë deri në 9-ën do të thotë të ulten të mesmen dhe filloren edhe përgaditja e një rregullorje për shkollat e mesme dhe ato fillore është një ekzistuese që 13-14 vite e rrethanat ndryshojnë kushtet ndryshojnë e besoj që duhet edhe ata me pregaditë një rregullore të re, a keni ndonjë planë në këtë drejtim ndonjë strategjie të përgjithshme për arsimin, në bazë të buxhetit që e pashë sot nuk keni, nuk ka në horizont kurgjo, mirëpo nashta keni ndonjë donator ku e di që ne nuk e dimë.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë drejtor fjala për juve.

### **Besnik Hulaj**

Po filloj prej Orgesit po është e vërtetë se kem pas tema kemi pasur edhe vjet dikund ka fundi i vitit kerkes per printer dhe kompjuter, mirpo tenderat qe dalin ne komun dalin 2 herë në vit. Ne kërkes kemi bërë jemi duke e pritur furnizimin se nuk mundemi mi ble direkt pa tender kërkesa është bërë të hënën e kam kryer siq i ka dal edhe afati internetit e kam bërë pagesen e internetit dhe një herë prej drjetoris se arsimit. Te Leotrimi për dru! Dru për fat të mirë ka në të gjitha shkollat ka rezerva se vazhdimisht kemi marrë më shumë dhe ka rezerva, nuk kemi menduar ndonjëher donjë nxemje me ngrohje termale paralelja e ndame në bush, paralelja e ndame ne Lumardh kemi fillu me i pajisur me kondicioner me klima mirëpo jemi duke shikuar sivjet është si test na kemi parapa si drejtori e arsimit ndohta jemi gabim ndoshta kemi edhe te drejt, jemi duke e parapa qe e kemi marr ne minus 20 e diqka grad të cilat janë për dimër jemi tu provu sivjet mundem me kanë funksionale edhe gjat dimrit ne kemi parapa atë alternativ edhe besoj se në të ardhmen do ti largojm drutë, sepse çdo problem që po na bëhet si për ankesën OSHP është hera e 1-rë që ka pasur ankesa sivjet ndoshta mundet me

pas ankesa prapë mirpo per fat te mir drut i kemi te furnizume ka rezerva ende ta shohim deri në fund këtë procedur.

#### **Hajdar Sutaj**

Leutrimi e ka një pyetje

#### **Leutrim Hadergjonaj**

Drejtor unë të pyeta se qdo vit ka 500 deri ne 800 mijë euro po hargjohen me 10 përqindshin për dru, zgjidhe nuk ke asnjëherë nëse i ke 25 shkolla ka 20.000 euro bën pompa termike ma madhja që e ka në çdo shkollë jashta komunës dyqanit menjëherë ti shpenzon 500.000 euro jo ma shumë edhe për 5 vjet nuk i shpenzon 200.000 euro rryme me pomp termike domethonë me çmimin qajo kosto që ka me shpenzu këtë vit drut ti me qato mjete kishe mundur mi kry krejt pompat termike edhe rrymen per 3 vjet me se paku te pagume edhe ti kurr mos me pas nevoj me qit ka 700.000 euro planifikim qdo vit për dru duhet me ja ba një analizat më të thellë nuk ke nevoj mi testu për mendimin tim se nëse shënon te prodhuesi i klimës ose pompës termike që për 50 metra katrorë, duhet qikaq kapacitet ti ata veqë e ke të sigurt se nuk dështon domethanë e ke sigurt që ata ka me nxehe ose ka me ftof, u kon mir ndoshta për vitin tjeter se nëse dështon kjo procedur me rikthy me bo një zgjedhje të përhershme tashmë ka kalu koha kush mi shti drut fmija në klas të parë, korriqi qe i thojm ne aj me ardh mi shti drut... por rrymë ki, absolut është inventori që deri në 4 orë nuk ka nevojë, ti nuk merresh me rrymë... me shti dru fëmija në klas të parë, me shti dru në shporet e mu djeg qdo dit, qajo është pollaver

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Leutrim, drejtor a ke diqka shtes drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën

#### **Besnik Hulaj**

Problemi është se na e kemi parapa ma mir me klima se sa me nxemje se shumica e shkollave nuk kanë radiator, nuk kanë pajisje për me ardh deri te një nxemje termike edhe fillimi ..përfundimi i vitit shkollor të qershorit dhe fillimet e shtatorit po janë të nxehta si praktikë qe e kemi bo dhe sivjet është si provë a po kalojm mir me klima a jo se klima i kryen dy funksionet dhe nxemjen edhe ftofjen, nëse është funksionale është shumë ma ekologjike nuk kan nevoj me ndez zjerma problem pak a shum po i frigohem rrymes se rryma po ndalet shpesh. Tash të gjith jemi prezent se rryme vetëm dje na u ka ndalur ne Deçan mbi 2 orë dhe tash të gjitha ato shkolla ata nxanca pa rrymë është problem jemi duke shikuar se i kemi shti edhe disa shkolla ne investime te mbrenshme nëse afrojmë me i pasë të gatshme për me hy pse jo edhe nxemjet normale sepse per nxemjet normale edhe te performanca kom marr vrejttje sepse nuk e kemi as një shkoll me kete pajisje deshta me... E Ramja e numrav te nxënsave per nxemje besoj qe bisedum e te ramja e numrit te nxënësve vitim e kalumë i kem pasë dikun rreth 200 nxënës kem pas ma pak kët vit i kemi vetëm 50 nxënës më pak që janë regjistruar në shkoll mirëpo nuk është numer real për arsye se deri në fund të tetorit nuk regjistrohen dhe ka lëvizje si për parashkollor si për klas të para po krahasim vitim e kalu me ket vit do me than kemi numer me te vogel me ramje te nxënësve dhe të shpërngulja në botën e jashtme, kemi pasur vjet 12 femij dhe 3 mesimdhenes dhe sivjet viti ka filluar me më shumë si regjister sepse prindërit hala nuk kan bërë kërkesë për me i tërhjek dokumentet prej shkollave ende nuk e kemi si regjister dhe ky numer ne raport tjeter vjen i sakt sepse vetem ne kete fillim të muajit i kam pasur 2 mësimdhënës qe kan shkuar ne boten e jashtme.

#### **Hajdar Sutaj**

Hyrije mfal a pate pyetje shtes a në rregull edhe ja ke permendur emrin urdhëro

#### **Hyri Dobrunaj**

Për secilin, klasët e para në komunën e deçanit sa ka qenë vitin e kalum numri dhe sa është këtë vit aty tani ne e shohim a është rritur apo ka ra për secilën klas veq e veq qysh e ke për gjimnaz njësoj ky është qëllimi.

#### **Hajdar Sutaj**

Drejtor urdhëro Besnik Hulaj

#### **Besnik Hulaj**

Këta e kemi bërë për arsye se ne e kemi cek edhe numrin regjistrimit 1 deri 5 edhe 1 deri 9 edhe që janë 50 nxënës më pak këtë vit i kemi marrë të gjitha të dhënat e këti raporti, e për me analizu raportin të këti viti edhe vitit të kaluar e kam pas shumë të lehtë sepse i kam pasur të gjitha të dhënat por kamë bërë raport për vitin 2024-2025, nuk kam pasur raport për....

**Hajdar Sutaj**

Drejtor ju urojm për fillim vitin e ri shkollor 2024-2025 ju urojmë suksese, ju uroj punë të mbarë faleminderit për sqarimet për spjegimet faleminderit edhe prej diskutimeve të anëtarëve të kuvendit.

Kalojmë si pikë të rendit të ditës jemi te të ndryshmet nuk ka pasur dikush ndonjë paraqitje për të ndryshmet nuk është lajmëru dikush diçka, po urdhëro Vaton Istrefaj e ka fjalën.

**Vatan Istrefaj**

Personalisht tek pika te të ndryshmet kam disa pyetje për kryetarin ose ekzekutivin komunal, po asnjëri nga ata që janë pyetje të adresume, nuk është këtu pjesëmarrës, kështu që pyetjet ne vetum me i marr me i futë në gjep.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit shum, atëherë e mbylli këtë seancë, takohemi në seancat e ardhshme faleminderit.

